



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

---

**AD/GJTHFR.nr.7/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur në çështjen disiplinore, sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga pala ankuese T.B., avokat nga Gjakova, me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj S.K., në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 3 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 30 Qershor 2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj S.K., e paraqitur nga pala ankuese T.B., avokat nga Gjakova, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj përkatësisht autoriteti kompetent i kësaj gjykate - kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, *(në tekstin e mëtejme autoriteti kompetent)*, më 7 qershor 2023 ka pranuar ankesën e palës ankuese T.B., avokat nga Gjakova (tutje ankuesi), me pretendimin për shkelje disiplinore nga neni 5 par.1 pika 1. 3 lidhur me par.2 pika 2.2 dhe 2.7 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ndaj gjyqtarit S.K., i cili sipas ankuesit deri sa ka qenë Kryetar i Trupit Gjykses, në çështjen juridiko – penale sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Pejë, PP.nr.128/2012 dt.27.06.2012, e cila çështje penale është zhvilluar në Gjykatë sipas

numrit të evidentuar të lëndës 2020:082166, ndaj të akuzuarit S.D.. Aktgjykimi i nxjerrë në riprocedurë është publikuar me datë 20.01.2023, ndërsa në aktgjykim shënon se është përpiluar me datë 18.03.2023, ndërsa mua si i autorizuar i palës së dëmtuar, z.H.H. e ka ardhur përmes postës me datë 03.05.2023, kështu që janë tejkualuar afatet e përpilimit dhe dorëzimit të aktgjykimit, duke kërkuar që të verifikohet edhe në sistem smil se a është i saktë konstatimi se aktgjykimi është përpiluar me datë 18.03.2023.

Ankuesi, po ashtu ka theksuar se aktgjykimi me numër të lëndës 2020:082166 i datës 18.03.2023, nuk i është dorëzuar edhe palës së dëmtuar, ndërsa Gjykata ka detyrim që aktgjykimin ti ja dërgon edhe palës së dëmtuar. Me datë 9 maj 2023, pra 1:29 PM, i kam dërguar e-mail gjykatës që aktgjykimi ti dërgohet edhe palëve të dëmtuara, gjykata nuk ka vepruar. Me datë 17 maj 2023, përsëri gjykatës i kam përsëritur e-mailin me përmbajtje të njëjtë, ku zyrtari i gjykatës ka konfirmuar pranimin e këtij e-maili, por aktgjykimi nuk i është dërguar palëve të dëmtuara dhe gjyqtari nuk ka respektuar nenin 368 të KPPRK. Të dëmtuarit janë palë në procedurë, në nenin 63 nënpar 1.7 të KPPRK-së, të cilëve ju kanë mohuar të drejtat e garantuara me ligj.

Po ashtu, ankuesi ka theksuar se pas anulimit të aktgjykimit PKR.nr.25/16 të datës 03.03.2019 me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.526/2019 të datës 25.02.2020, shqyrtimi i parë në procedurë është mbajtur me datë 23.05.2022, pas më shumë se dy vite, dhe veprimi i tillë paraqet shkelje të së drejtës në afat të arsyeshëm, nëse jo dashje atëherë me neglizhencë ekstreme, duke i propozuar që ndaj gjyqtarit të fillohet procedura disiplinore.

Gjyqtari e ngarkuar me këtë çështje S.K., në deklaratën e tij me shkrim dërguar përmes e-mailit me datë 15.06.2023 lidhur me pretendimet e palës ankuese, ka theksuar se pretendimet e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar H.H., av.T.B., janë krejtësisht të pabazuara duke i arsyetuar si në vijim:

- Sa i përket pretendimit se janë tejkualuar afatet për përpilimin dhe dorëzimin e aktgjykimit nuk qëndrojnë ngase aktgjykimi me numër të lëndës 2020:082166 ndaj të pandehurit S.D. është shpallur dhe publikuar me datë 20.01.2023. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, që ka qenë në fuqi në këtë kohë (neni 369 par.1 i KPPK-së) *“Aktgjykimi i shpallur duhet të përpilohet me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve kur i akuzuari nuk gjendet në paraburgim. Në rastin konkret i akuzuari nuk ka qenë në paraburgim. Në të njëjtën dispozitë ligjore theksohet se: kur rasti është*

*i ndërlikuar, gjyqtari i vetëm gjykues apo Kryetari i Trupit Gjykues mund të kërkoj nga Presidenti i Gjykatës që të zgjasë afatin e përpilimit me shkrim të aktgjykimit deri në gjashtëdhjetë (60) ditë”.* Në rastin konkret duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e kësaj çështje penale, meqë kjo lëndë është shumë voluminoze sepse që nga data 11.04.2012 ende nuk ka marrë epilogun përfundimtar me aktgjykim të formës së prerë, kryetari i trupit gjykues me kërkesën e datës 20.02.2023 ka kërkuar nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj zgjatjen e afatit për përpilim me shkrim të aktgjykimit edhe për një periudhë kohore prej tridhjetë (30) ditëve.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, me aktvendimin e datës 21.02.2023 e ka aprovuar kërkesën për zgjatjen e afatit për përpilim të aktgjykimit për periudhën prej tridhjetë (30) ditëve dhe atë deri me datë 20.03.2023. Aktgjykimi është përpiluar edhe më herët, para kësaj date, por në të figuron data 18.03.2023, në të njëjtën kohë kur është regjistruar në SMIL. Andaj nga kjo rezulton se në asnjë mënyrë nuk janë tejkalluar afatet ligjore për përpilim me shkrim të këtij aktgjykimi.

- Sa i përket pikës së dytë të ankesës se aktgjykimi nuk i është dorëzuar edhe palës së dëmtuar, gjyqtari S.K., ka theksuar se edhe ky pretendim i ankuesit nuk qëndron, sepse Aktgjykim në fjalë palës së dëmtuar i është dorëzuar në të njëjtën kohë kur i është dorëzuar edhe avokatit T.B. dhe të gjithë palëve në procedurë dhe se për këtë ekzistojnë dëshmitë përkatësisht fletëdërgesat për dorëzim ku nga këtu shihet qartë se pala e dëmtuar H.H. aktgjykimin në fjalë e ka pranuar përmes postës më dt. 04.05.2023, kur një ditë më parë përkatësisht më datën 03.05.2023 e ka pranuar edhe përfaqësuesi i tij av. T.B. Gjyqtari ka theksuar se edhe palët tjera në procedurë e kanë pranuar përafërsisht në kohë të ngjashme nga një kopje të këtij aktgjykimi, Andaj nga kjo rezulton se të gjitha palët në procedurë aktgjykimin e kanë pranuar në të njëjtën kohë dhe nuk qëndron pretendimi i ankuesit av. T.B., se Gjykata të dëmtuarit H.H., nuk ia ka dërguar aktgjykimin me kohë, por ne nuk mund ti dijmë arsyet se përse i dëmtuari nuk e ka njoftuar përfaqësuesin e tij av. T.B., për pranimin e aktgjykimit. Zyrtarja ligjore e kësaj gjykate, A.S. më dt. 19.05.2023 ne ora 11:11 e përmes emailit e ka njoftuar av. T.B., se pala e dëmtuar H.H., të cilin ai e përfaqëson e ka pranuar aktgjykimin në të njëjtën kohë kur e keni pranuar edhe ju, mirëpo ndoshta për shkak të rrjetit të dobët të internetit nuk ka arritur ta pranon këtë shkresë, nga një kopje të fletëdërgesave që i kanë pranuar palët. Ndërsa në njoftimin shtesë dërguar përmes e-mailit me datë 22.06.2023, gjyqtari ka sqaruar se në lëndën me numër unik 2020:082166 dhe

numër dosje 2020:082167, ka marr vendim përkatësisht Aktgjykimin me datë 18.03.2023, të cilin e ka vendosur në SMIL me datë 27.04.2023. Ngarkimi i vendimit në SMIL është dashur të pritet deri sa është rregulluar problemi në SMIL, duke theksuar se nuk ka pasur mundësi të shtojë detyrë në lëndë për ta ngarkuar vendimin. Për këtë problem ka theksuar se ka qenë e njoftuar edhe trajnerja e SMIL-it, dhe pas rregullimit të këtij problem nga zyrtarët e SMIL-it, është vendosur aktgjykimi dhe i njejtë është ekspeduar, të cilin vendim pala e dëmtuar H.H., e ka pranuar me datë 04.5.2023, ndërsa avokati i tij T.B., të njejtë vendim e ka pranuar me datë 03.05.2023.

- Sa i përket pikës së tretë të ankesës së pales ankuese se, shqyrtimi i parë në riprocedurë është mbajtur me datë 23.05.2022, pas më shumë se dy vite pasi që lënda është kthyer në rivendosje nga Gjykata e Apelit, gjyqtari ka theksuar se në kohën kur të gjithë e dijmë se gjatë vitit 2020 – 2021 në të gjithë botën, pra edhe në Kosovë ka qenë i përhapur kulmi i pandemisë COVID 19, ku Gjykatat kanë punuar me staf esencial të reduktuar dhe i kanë vendosur vetëm lëndët e natyrës urgjente të cilat dihet se cilat kane qenë të asaj natyre e aq më tepër kur palët të cilat është dashur të marrin pjesë në seanca kanë qenë të komunave tjera dhe me doemos e kemi pasur obligim edhe ruajtjen e shëndetit të tyre nga infeksioni me COVID 19. E po ashtu njëherë seanca është shtyer me kërkesën e vetë palës ankuese i cili gjatë zhvillimit të kësaj procedure gjyqësore përmes parashtrësës së dorëzuar në Gjykatë ka kërkuar shtyerjen e seancës për shkak të gjendjes shëndetësore të tij (thyerjen e këmbës).

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtarit të rastit si dhe shkresave tjera që ka bashkangjitur pala ankuese, e po ashtu edhe shkresave që janë të vendosura në sistem SMIL ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga gjyqtarit S.K.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Pejë PP.nr.128/2012 datë 27.06.2012 e datës. 27.06.2012, kundër të pandehurit S.D. nga Peja, për veprën penale të vrasjes së rëndë në tejkalim të mbrojtës se nevojshme nga neni 147 pika 11, lidhur me nenin 8 pika 4, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armeve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datë 20.01.2023 ka marr dhe publikisht ka shpallur aktgjykimin, ku të akuzuarin S.D., konform nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të

KPPK-së, lidhur me nenin 8 par.1 dhe 2 të KPK-së e ka liruar nga akuza për veprën penale të vrasjes së rëndë në tejkallim të mbrojtës se nevojshme nga neni 147 pika 11, lidhur me nenin 8 pika 4 të KPK-së, ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armeve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, e ka shpallur fajtor dhe ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, duke i llogaritur kohën e kaluar në paraburgim prej 12.04.2012 deri më datë 17.10.2012. (paraprakisht lidhur me këtë çështje penale nga Gjykata e Apelit të Kosovës janë anuluar tre herë aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë, dhe atë një herë është anuluar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë P.nr.310/2012 i datës 17.10.2012, një herë është anuluar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.372/2013 i datës 24.02.2015 dhe një herë është anuluar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.25/16 i datës 03.03.2019).

Kryetari i Trupit Gjykses S.K., pas shpalljes së aktgjykimit, ka bërë kërkesë me shkrim duke kërkuar nga Kryetari të Gjykatës zgjatjen e afatit për përpilimin me shkrim të aktgjykimit me arsyetimit se pas shpalljes së aktgjykimit kundër të pandehurit nuk ka mund që në afatin e paraparë ligjor të përfundoj aktgjykimin me shkrim për shkak të ndërlikueshmërisë së çështjes si dhe angazhimeve tjera, me ç'rast kryetari i gjykatës pas analizimit të kërkesës dhe shkresave të lëndës gjeti se kërkesa e Kryetarit të Trupit Gjykses është e bazuar dhe me Aktvendimin 2020:082166 të datës 21.02.2023 ka aprovuar kërkesën për zgjatje të afatit për përpilim me shkrim të aktgjykimit për periudhën prej tridhjetë (30) ditëve dhe atë deri më datë 20.03.2023.<sup>1</sup> Aktgjykimi 2020:082167 i shpallur me datë 20.01.2023, sipas deklarimit të gjyqtarit është përpiluar me shkrim me datë 18.03.2023.

Në bazë të verifikimit të të dhënave nga sistemi SMIL, por edhe nga vetë deklarimi i gjyqtarit S.K., shihet se aktgjykimi është i vendosur në këtë sistem me datë 27.04.2023, e jo në kohën kur është përpiluar me shkrim siç është data në Aktgjykim, pasi për shkak të problemeve teknike për të cilat sipas gjyqtarit ka qenë e njoftuar edhe trajnerja e SMIL-it, nuk ka mundur ta vendos aktgjykimin në këtë sistem me datën kur edhe është përpiluar aktgjykimi, pasi që ashtu siç edhe ka deklaruar gjyqtari, për shkak të pamundësisë për të shtuar detyrë të re në sistem dhe për ta ngarkuar këtë vendimin, dhe pas rregullimit të këtij problemi nga zyrtarët e SMIL-it, është vendosur Aktgjykimi në smil dhe i njëjti i është ekspeduar palëve, ku sipas fletëkthesës që i ka

---

<sup>1</sup> Aktvendimi i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj 2020:082166 i datës 21.02.2023

bashkangjitur gjyqtari konstatohet se përfaqësuesi i palës së dëmtuar av.T.B., aktgjykimin e ka pranuar me datë 03.05.2023, ndërsa i dëmtuari H.H., aktgjykimin e ka pranuar me datë 04.05.2023<sup>2</sup>. Gjyqtari ka theksuar se të gjitha palët tjera në procedurë vendimin e kanë pranuar afërsisht në data të ngjashme. Andaj, nuk mund të vijmë në përfundim se gjyqtari ka tejkaluar afatet për përpilimin dhe dorëzimin e aktgjykimit, pasi që në rastin konkret kemi pasur të bëjmë me probleme teknike të paraqitura në sistemin Smil, e që këto probleme janë evidente dhe nganjëherë të shpeshta sidomos kur kemi të bëjmë me lëndë të kthyer në rigjykim dhe në këtë rast krijohen dosje të reja në SMIL e që shpesh tek përdoruesit e këtij sistemi paraqesin konfuzitet dhe mund të vije edhe deri tek ndonjë gabim në plotësimin e hapave, gjë që shpie tek nevoja për ndihmën e tranjerave të Smil-it, por edhe zyrtarëve të TI-së për ti evituar këto probleme që janë teknike të sistemit kompjuterik SMIL. Dhe duke pasur parasysh këto rrethana sigurisht që ka ardhur deri tek vonesa për ekspedim të vendimit, por jo edhe të përpilimit me shkrim të aktgjykimit, dhe atë për shkak të problemeve teknike të paraqitura gjatë ngarkesës së vendimit në sistem, andaj nuk mund të themi se gjyqtari ka bërë shkelje disiplinore në drejtim të mos trajtimit të palëve në procedurë ashtu siç kërkohet me ligj.

Sa i përket pretendimeve të ankuesit se është shkelur renditja e veprimit në këtë çështje pasi që sipas ankuesit, pas anulimit të aktgjykimit të kësaj Gjykate PKR.nr.25/16 të datës 03.03.2019, me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.526/2019 datë 25.02.2020, dhe se shqyrtimi i parë në këtë çështje është bërë me datë 23.05.2022, kjo është më se evidente se ka qenë një proces i stërzgatur, që nga paraqitja e aktakuzës nga ana e Prokurorisë së Qarkut në Pejë me datë 27.06.2012, por duke pasur parasysh në këtë çështje penale Gjykata e Apelit për tre herë me radhë ka anuluar aktgjykimet dhe për herë të tretë në rigjykim, kjo çështje penale i është ri caktuar gjyqtarit S.K. Gjatë kësaj periudhe kohore siç është e njohur për të gjithë kemi pasur periudhën e pandemisë me covid 19 dhe për një periudhë relativisht të gjatë institucionet publike përfshirë edhe gjykatat kanë punuar vetëm rastet urgjente. Për të vazhduar edhe për një periudhë punën me staf të reduktuar dhe trajtimin e lëndëve të natyrës urgjente. Po ashtu gjatë periudhës 1 janar 2021 deri në fund të shtatorit 2021 gjyqtari S.K. ka qenë ushtrues i detyrës së kryetarit të Gjykatës, i cili përveç trajtimit të lëndëve që ka qenë i ngarkuar si gjyqtar, i njëjti ka pasur edhe

---

<sup>2</sup> Fletëdërgesa për dorëzim të aktgjykimit e gjeneruar në sistemin SMIL me datë 28.04.2023, në emër të z.H.H., e pranuar me datë 04.05.2023 (nënshkruar nga djali), dhe Fletëdërgesa për dorëzim të aktgjykimit e gjeneruar në sistemin SMIL me datë 28.04.2023 në emër të av.T.B., e pranuar me datë 03.05.2023.

angazhimet e tija në kryerjen e detyrave të Kryetarit të Gjykatës, andaj të gjitha këto janë rrethana objektive që kanë ndikuar që gjyqtari të mos e trajtoj në rigjykim këtë çështje ashtu siç kërkohet me ligj, por assesi nuk mundë të vijmë në konkludim se gjyqtari në vazhdimësi nuk i ka kryer detyrat e tija zyrtare me kohë ashtu siç përcaktohet me ligj ashtu që kjo të konsiderohet si shkelje disiplinore, pasi që i njëjti vazhdimisht ka qenë i ngarkuar me lëndë të natyrave urgjente të cilat është dashur të trajtohen me prioritet.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore, nuk mbështetet në fakte dhe prova mbi të cilat do të ngritët eventualisht dyshimi mbi shkelje të supozuar disiplinore, andaj si e tillë refuzohet si e pa bazuar.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,  
AD/GJTHFR.7/2023, datë 30 qershor 2023**

**Mustaf TAHIRI**

---

**Kryetar i Gjykatës**

**Iu dërgohet:**

Avokat T.B. - Parashtrues i ankesës

S.K. - Gjyqtar

Këshillit Gjyqësor të Kosovës